



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

*Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre*

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K3/S19-12 Prot.

Tiranë 27/10/2025

Nr. Dok. 202501851/12

Lënda: *Rekomandim për ekzekutimin e vendimit nr. 95, datë 26.06.2024 dhe nr. serie 0095 "Për prishje objekti", të nxjerrë nga Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, në Bashkinë Sarandë*

Drejtuar: **Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, në Bashkinë Sarandë**

Sarandë

Kryetarit të Bashkisë Sarandë

Sarandë

Këshillit Bashkiak Sarandë

Sarandë

Për dijeni: **Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit**

Tiranë

Znj. S.I

Sarandë

Të nderuar,

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit, sikurse jeni në dijeni, ka paraqitur një ankesë shtetësja **S.I**, ndaj Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, të Bashkisë Sarandë. Në këtë ankesë

ndër të tjera ka parashtruar se, që prej tre vitesh po shfrytëzon një plazh publik me vendndodhje në lagjen nr 1, rruga: “Butrinti”. Të drejtën e shfrytëzimit të këtij plazhi ajo e ka fituar sipas kontratës së lidhur me Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe me Bashkinë Sarandë.

Sikundër shkruan ankuesja pas marrjes së lejes nga autoritetet e mësipërme, nga Bashkia Sarandë i është dërguar një shkresë për caktimin e piketave të plazhit. Mirëpo ajo sqaron se është gjendur para faktit se në këtë plazh i kanë dalë disa “pronarë” pa asnjë lloj dokumentacioni ligjor (certifikatë pronësie të lëshuar nga DVASHK-ja Sarandë), të cilët janë duke bërë punime në terren pa patur asnjë leje të lëshuar nga Bashkia Sarandë.

Në rrethanat sa sipër, ankuesja ka shpjeguar se, ka bërë disa ankesa në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Sarandë, nëpërmjet të cilave ka kërkuar bllokimin e këtyre punimeve, por nga ana juaj nuk po merrej asnjë masë përkundrejt tyre. Kjo situatë paligjshmërie ka ndikuar që edhe pse me dokumentacion të rregullt ankuesja është penguar për kryerjen e punimeve për të bërë rregullime në plazh dhe për vazhdimin e të gjitha proceseve, në respektim të kontratës dhe të lejes së dhënë nga Ministria për shfrytëzimin e plazhit.

Në këto kushte ankuesja ka kërkuar ndërhyrjen e institucionit të Avokatit të Popullit për shqyrtimin dhe verifikimin e kësaj çështjeje me qëllim të mbrojtjes sa më efektive të të drejtave dhe interesave të saj të ligjshme.

Pas regjistrimit të kësaj ankese, Avokati i Popullit, i ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji për garantimin e mbrojtjes së të drejtave, lirive themelore dhe interesave të shtetasve nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka konstatuar se ankesa plotëson të gjithë kushtet thelbësore të formës dhe të përmbajtjes për t’u konsideruar në kompetencën e tij lëndore, ndaj bazuar në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, respektivisht nenet 13,17 shkronja “a” dhe 18 shkronja “b”, ka vendosur t’a pranojë ankesën dhe të fillojë procedurën e shqyrtimit të çështjes. Kjo në përputhje me paragrafin e parë, të nenit 13, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike”*.

Për shqyrtimin me objektivitet të kësaj çështjeje dhe për të mundësuar një hetim të plotë administrativ, në vështrim të nenit 63, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: *“Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentat dhe informacionet e kërkuara prej tij”*, si dhe në nenin 19, gërma “b” të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit” të ndryshuar, në të cilin parashikohet se : *“Avokati i Popullit ka të drejtë: b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin”*, me tonën nr. K3/S19-2 prot., datë 04.07.2024, “kërkesë për shpjegime”, i kemi

kërkuar Bashkisë Sarandë, të na dërgojë një informacion sa më konkret dhe gjithëpërfshirës, si dhe dokumentacionin përkatës ligjor, që ka të bëjë me çështjen objekt hetimi administrativ.

Me Tuajën nr. 3997/1 prot., datë 29.07.2024, na keni kthyer përgjigjen se, për rastin në fjalë, Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, në bazë të ligjit nr. 9780/2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar, VKM-së nr. 894/2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore”, pas konstatimit të kundërvajtjes ka mbajtur praktikën ligjore si më poshtë vijon:

1. Proces-verbalin nr. 59, datë 18.06.2024, dhe nr. serie 0209, “Për konstatimin e kundërvajtjes” në ngarkim të subjektit M.DH,
2. Vendimin nr.60, datë 26.06.2024 dhe nr. serie 0060, “Për dënimin me gjobë”, si dhe
3. Vendimin nr.95, datë 26.06.2024 dhe nr. serie 0095, “Për prishjen e objektit të kundërligjshëm”.

Nga kontrolli i ushtruar ka rezultuar se, objekti i konstatuar nga inspektorët e IMT-së ndodhet në hapësirën e përparme, (ana e detit) në parcelën nr. SR-41, me sipërfaqe 139 m2, të kontraktuar nga subjekti M.DH me anë të kontratës: “Për përdorimin e hapësirës së plazhit/kontratë qiraje nr.1025 prot., datë 08.04.2024, e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, nr.1976 prot., datë 12.04.2024 e Bashkisë Sarandë, i cili është një objekt (platformë) me strukturë metalike të fiksuar pjesërisht në tokë dhe në det, si dhe e shtruar me dërrasa, për të cilën është mbajtur praktika sikurse sipër cituar.

Më tej jeni shprehur se, parcela e plazhit nr. SR-41 rezulton e kontraktuar nga dy subjekte: nga M.DH me sipërfaqe totale të kontraktuar prej 139 m2 dhe nga V. C me sipërfaqe prej 250 m2. Nga IMT –ja Bashkia Sarandë do të merren masat për ekzekutimet e vendimeve brenda afateve ligjore.

Në vijim keni shpjeguar se, Bashkia Sarandë bazuar në nenin 4 të kontratës për përdorimin e hapësirës së plazhit të nënshkruar midis Agjencisë Kombëtare të Bregdetit në cilësinë e qiradhënësit dhe subjektit V.C dhe përfitues Bashkia Sarandë, i ka dorëzuar sipërfaqen prej 250 m2, (sipas planvendosjes pjesë përbërëse e kësaj kontrate), subjektit të kualifikuar V.C. Ky fakt rezulton nga proces-verbali datë 30.05.2024, i mbajtur nga përfaqësues të Bashkisë Sarandë dhe subjektit V.C për parcelën e plazhit me nr. identifikues SR-41, proces-verbal i cili është nënshkruar nga vetë shtetësja Sabrina Ismailaj (përfaqësuese me prokurë e shtetasit V.C). Ndërsa përsa i përket objektit të kundërligjshëm të konstatuar në parcelën e plazhit nr. SR-41, jeni shprehur se IMT –ja ka mbajtur procedurën e plotë ligjore.

Megenëse kemi konstatuar se nga ana juaj dokumentacioni nuk është dërguar i plotë ju kemi ridrejtuar me shkresën nr. K3/S19-8 prot., datë 20.12.2024, në përmjet të cilës ju kemi rikërkuar të na dërgoni kopje të vendimit nr. 60, datë 26.06.2024 dhe nr. serie 0060, “Për dënimin me gjobë”, si dhe të vendimit nr. 95, datë 26.06.2024 dhe nr. serie 0095, “Për prishjen e objektit të kundërligjshëm”, pasi nga ana juaj ishte dërguar vetëm kopje e proces-verbalit nr.

59, datë 18.06.2024 dhe nr. serie 0209, “Për konstatimin e kundërvajtjes” në ngarkim të subjektit M.DH. Gjithashtu referuar përmbajtjes së përgjigjes sa sipër, si dhe me qëllim zgjidhjen përfundimtare të rastit, ju kemi kërkuar që lidhur me rastin të na dërgoni një informacion shtesë si dhe dokumentacionin përkatës lidhur me sa më poshtë vijon:

- *Cilat janë veprimet e ndërmarra nga ana juaj në zbatim të vendimit për prishje të objektit të kundërligjshëm, nr. 95, datë 26.06.2024 dhe nr. serie 0095?*
- *Aktualisht a është prishur ky objekt?*
- *Nëse jo cilat janë shkaqet ligjore që kanë ndikuar në mosprishjen e tij?*
- *A është vjelë kjo gjobë nga ana juaj?*

Në përgjigjen e dhënë prej jush me shkresën nr. 7206/1 prot., datë 07.01.2025, na keni informuar ndër të tjera se, për rastin në fjalë Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, në Bashkinë Sarandë, në funksion të ushtrimit të kompetencave në bazë të ligjit nr. 9780/2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e Territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, VKM-së nr. 894/2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore” të ndryshuar, ka mbajtur praktikën e plotë ligjore.

Përsa i përket ekzekutimit të vendimit të prishjes keni bërë me dije se, objekti është prishur pjesërisht. IMT-ja aktualisht nuk disponon mjetet e nevojshme për të prishur plotësisht këtë objekt, si pasojë është kërkuar mbështetje nga Inspektoriati Kombëtar i Territorit (IKMT) për ekzekutimin e vendimeve të prishjes të IMT-së, Bashkia Sarandë në të cilën është pjesë edhe objekti në fjalë. Objektet janë vlerësuar nga grupi i punës i përbashkët nga IKMT dhe IMT nga data 16.12.2024 deri më 20.12.2024.

Në analizë sa sipër, ju jemi drejtuar me shkresën nr. K3/S19-10 prot., datë 14.05.2025, (për dijeni edhe IKMT-së), nëpërmjet së cilës ju kemi kërkuar të na jepni sqarimet e nevojshme (përfshirë këtu edhe pyetje të parashtruara nga ana jonë në shkresën e mëparshme të cilat nuk kanë marrë përgjigje nga ana juaj në mënyrë shteruese), pasi i konsiderojmë të rëndësishme në kuadër të hetimit administrativ të rastit, konkretisht ju kemi kërkuar të na sqaroni lidhur me sa më poshtë vijon:

- *Përgjatë kësaj kohe nisur edhe nga bashkëpunimi që i keni kërkuar IKMT-së, a është realizuar prishja plotësisht e objektit të kundërligjshëm?*
 - *Nëse jo, cilat janë shkaqet që kanë ndikuar në mosprishjen e tij?*
 - *Cilat janë veprimet e ndërmarra nga ana juaj në zbatim të vendimit për prishje të objektit të kundërligjshëm, nr. 95, datë 26.06.2024 dhe nr. serie 0095, në ushtrim të përmbushjes së kompetencave tuaja ligjore?*
 - *Na dërgoni kopje të praktikës së plotë ligjore të ndjekur nga ana juaj lidhur me rastin, (sikurse kërkuar edhe në shkresën tonë nr. K3/S19-8 prot., datë 20.12.2024, përfshirë këtu edhe korrespondencën me IKMT-në) .*
 - *A është vjelë kjo gjobë nga ana juaj?*
- Lidhur me këtë shkresë nga ana juaj nuk është kthyer asnjë përgjigje .

Nga komunikimi me ankuesen, jemi vënë në dijeni të faktit se nga ana e IKMT-së ju është dërguar shkresë për prishjen e ndërtimit të paligjshëm, mirëpo nga ana juaj, nuk rezulton që të jenë marrë masat përkatëse për prishjen e objektit të kundërligjshëm, me qëllim kthimin e ligjshmërisë në territor.

Nisur nga justifikimi i dhënë në shkresën e organit tuaj publik, 7206/1 prot., datë 07.01.2025, se objekti është prishur pjesërisht, pasi IMT-ja aktualisht nuk disponon mjetet e nevojshme për të prishur plotësisht këtë objekt, në ekzekutim të vendimit nr. 95, datë 26.06.2024 dhe nr. serie 0095 “Për prishje objekti”, dhe kërkit të bashkëpunimit me IKMT-në, për realizimin e prishjes së këtij ndërtimi të kundërligjshëm, kemi kryer një analizë të legjislacionit rregullator në fuqi, për të kuptuar bazueshmërinë e kësaj mënyre të trajtimit të çështjes nga ana juaj.

Ligji bazë specifik që përcakton fushën e veprimit dhe kompetencat e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, të njësive vendore është ligji nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar (*ligji nr. 9780/2007*). Në nenin 2, të këtij ligji parashikohet se, objekti i tij është përcaktimi i organeve për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme, si dhe i përgjegjësive të tyre.

Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, të njësive vendore, i përcaktuar si një nga organet e inspektimit ndërtimor, ka si përgjegjësi të tij ligjore,¹ ushtrimin e kontrollit të territorit dhe zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike e kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, si dhe të atyre të parashikuara në ligje të tjera. E gjithë kjo veprimtari zhvillohet mbi bazën e proceseve verifikuese dhe vendimmarrjes sanksionuese, të parashikuara këto në legjislacionin në fuqi.

Ndër detyrat/kompetencat e përcaktuara në ligjin nr. 9780/2007, për Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit, të njësive vendore, në shkronjën “d”, të nenit 5, përcaktohet detyrimi se gjatë ushtrimit të përgjegjësive të parashikuara në nenin 4, (të po këtij ligji), ky inspektoriat merr masat e mëposhtme:

d) vendos prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm.

Kjo kompetencë bëhet më e qartë nga përkufizimi i dhënë në paragrafin e fundit të këtij neni, ku parashikohet se: “Fjala “ndërtim/punim”, sipas këtij neni përfshin ato procese dhe/ose objekte ndërtimore që ndërtohen instalohen në territor, me vendosje të palëvizshme apo të përkohshme, që zhvillohen në dhe/ose mbi tokë, çdo veprim/proces ndërtimi, gërmimi, prishjeje, zgjerimi, riparimi, rinovimi, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në territor ose strukturë dhe i referohet gjendjes aktuale, vëllimit të punimeve të kryera, përfshirë dhe/ose rrethime të kundërligjshme në çastin e ushtrimit të inspektimit”.

Në vazhdim, në shkronjën “c”, të pikës 8, të nenit 12, të ligjit nr. 9780/2007, parashikohet se:

¹ Neni 4, paragrafi i parë, i ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar.

“Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore, për ushtrimin e përgjegjësisë dhe detyrave të parashikuara në këtë ligj, kanë të drejtë:

*c) **të përfshijnë në kontrollin e tij** prishjen e një ndërtimi ekzistues, **ndërtimin** apo punimet për ndërtimin e një objekti të ri, rikonstruksionin e objektit, riparimin e objektit, infrastrukturën tokësore dhe nëntokësore, si dhe punimet/**ndërtimet**, që paraqesin rrezik shembjeje, **me pasoja** për jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe **mbi pasurinë e të tretëve**”.*

Ndërkohë, në ligjin nr. 107/2014 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, të ndryshuar, pika 20 dhe pika 21, të nenit 3, si dhe në pikën 1, të nenit 39, parashikohet se:

“20. “Ndërtim është çdo objekt që ndërtohet ose instalohet në territor, me vendosje të palëvizshme apo të përkohshme, dhe që zhvillohet nën dhe/ose mbi tokë”,

21. “Ndërtim/punim pa leje”, janë ato procese dhe/ose projekte ndërtimore të kryera në mungesë të lejes së ndërtimit, deklaratës paraprake për kryerjen e punimeve ose të kryera në kushtet e një lejeje të shfuqizuar”,

“1. Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41, i këtij ligji”.

Në pikat 1-3, të nenit 51, të po këtij ligji, parashikohet se:

“1. Inspektimi ka për mision garantimin dhe mbrojtjen e interesit kombëtar për një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm të territorit, përmes parandalimit të punimeve dhe ndërtimeve të paligjshme, sipas këtij ligji dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij, si dhe ndëshkimin e drejtë të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat e këtij ligji.

2. Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, sipas këtij ligji, kryhet në përputhje me këtë ligj, aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe legjislacionit të zbatueshëm për inspektimin e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë.

3. Autoritetet e inspektimit bashkëveprojnë dhe bashkërendojnë veprimet inspektuese ndërmjet tyre, si dhe me autoritetet e planifikimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit. Kur vihet në dijeni të fakteve, edhe pse ato mund të mos jenë brenda sferës së tij të juridiksionit dhe përgjegjësisë, çdo autoritet i inspektimit njofton menjëherë autoritetin tjetër përgjegjës ose të interesuar”.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit”, të ndryshuar, si një akt tjetër normativ rregullator në nenin 1 të tij, parashikon se:

“1. Kjo rregullore ka si objekt përcaktimin e kushteve dhe procedurave të detajuara për zbatimin e instrumenteve të drejtimit të zhvillimit dhe për përmbajtjen, strukturën dhe procedurën e miratimit të dokumenteve të kontrollit të zhvillimit.

2. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të autoriteteve të zhvillimit për ushtrimin e funksionit të kontrollit të zhvillimit të territorit, në përputhje me ligjin nr.107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, si dhe garantimi i përdorimit të sistemit elektronik të lejeve nga të gjithë aplikuesit dhe institucionet e përfshira, me qëllim thjeshtimin e procedurave dhe ofrimin e shërbimit me një ndalesë”.

Së fundmi, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore” (VKM nr. 894/2015), në gërmën “a”, të nenit 1, parashikohet se kompetencat e dhëna në këtë akt nënligjor për kryeinspektorët/inspektorët e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit të njësisë vendore, parashikohen në mbështetje të nenit 12, të ligjit nr. 9780/2007.

Në vijim në nënëgërmat “ii” dhe “iv”, të gërmës “b”, të pikës 1, të VKM-së nr. 894/2015, parashikohet se:

“b) Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit pranë njësisë vendore:

- ii) kryen kontrolle në territorin administrativ të njësisë vendore, në bazë të planit mujor të punës, të miratuar nga kryeinspektori, si dhe në bazë të njoftimeve të marra nga institucionet qendrore, vendore dhe subjektet fizike e juridike;*
- iv) përfshin në kontrollin e tij punimin /zhvillimin/ndërtimin e një objekti të ri, prishjen e objektit, rikonstruksionin e objektit, riparimin e objektit, infrastrukturën tokësore e nëntokësore, si dhe prishjen e objekteve që paraqesin rrezik shembjeje, me pasoja për jetën e shëndetin e njerëzve dhe mbi pasurinë e të tretëve, në përputhje me ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, dhe me aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi”.*

Sikurse na rezulton, IMT-ja në Bashkinë Sarandë, i ka ushtruar këto kompetenca ligjore dhe në zhvillim të procedurës administrative për trajtimin e kësaj çështjeje ka mbajtur proces-verbalin nr. 59, datë 18.06.2024, dhe nr. serie 0209, “Për konstatimin e kundërvajtjes” në ngarkim të subjektit Mario Dhamo , si dhe ka nxjerrë vendimin nr.60, datë 26.06.2024 dhe nr. serie 0060, “Për dënimin me gjobë”, si dhe vendimin nr.95, datë 26.06.2024 dhe nr. serie 0095, “Për prishjen e objektit të kundërligjshëm”.

Në kuadër të zhvillimit të kësaj procedure administrative², vlerësojmë se momenti thelbësor që ka nevojë të analizohet në këtë çështje ka të bëjë me ekzekutimin e vendimit nr. 95, datë 26.06.2024 dhe nr. serie 0095 “Për prishjen e objektit të kundërligjshëm”, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, nga ana e organit tuaj publik.

² Në pikën 9, të nenit 3, të Kodit të Procedurave Administrative, parashikohet se:

“Procedurë administrative” është veprimtaria e një organi publik, me qëllim përgatitjen dhe miratimin e veprimeve konkrete administrative, ekzekutimin e tyre dhe rishikimin e tyre me mjete ligjore administrative”.

Në kuptim të parashikimeve të ligjit nr. 9780/2007, detyrimi parësor ligjor për ekzekutimin e këtij vendimi i lind IMT-së në Bashkinë Sarandë, si organi publik që ka nxjerrë këtë akt administrativ me natyrë ndëshkuese dhe që duhet ta ekzekutojë atë, me qëllim arritjen e pasojës së dëshiruar juridike të shprehur në vullnetin e vet organit publik në momentin e nxjerrjes së tij. Lidhur me këtë konstatim duhet evidentuar se vendimi i sipërcituar ka hyrë dhe është në fuqi dhe se, ai prodhon pasoja juridike.

Bazuar në kompetencat që gëzon nga ligji IMT-ja në Bashkinë Sarandë, del e qartë se ju keni ushtruar kompetencat tuaja ligjore me nxjerrjen e akteve administrative të nevojshme për trajtimin e këtij rasti, por konstatohet në vazhdim se ju si organ publik e keni ekzekutuar pjesërisht vendimin nr. 95, datë 26.06.2024 dhe nr. serie 0095 “Për prishjen e objektit të kundërligjshëm” për shkaqe që, sipas shpjegimeve të dhëna, lidhen me mungesën e kapaciteteve dhe të mjeteve të rënda për të kryer këtë ndërhyrje. Për këto arsye, shpreheni se keni kërkuar mbështetjen e IKMT-së, pavarësisht se ky dokumentacion nuk u paraqit përgjatë hetimit administrativ nga ana juaj, edhe pse e kemi kërkuar në mënyrë të përsëritur përgjatë korrespondencës tonë zyrtare me ju.

Në këtë kontekst në përputhje me legjislacionin në fuqi, IKMT-ja, ka kompetencën ligjore që, në përputhje me shkronjën “a”, të pikës 1, dhe shkronjat “a” dhe “c”, të pikës 2, të nenit 9/1, të ligjit nr. 9780/2007, të ushtrojë kompetencat e veta, që ligji i njeh IMT-së në Bashkinë Sarandë, në këtë çështje.

Më konkretisht, në këto dispozita të ligjit nr. 9780/2007, parashikohet se:

1. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, përveç detyrave të tjera, të parashikuara në këtë ligj, ka të drejtë që:

a) të ushtrojë përgjegjësitë e veta të njësisë vendore, sipas nenit 5, të këtij ligji, për ndërtim/punime të kundërligjshme në territorin e njësisë vendore, që nuk përfshihen në çështje, zona ose objekte me rëndësi kombëtare dhe në territor;

b) të ushtrojë të drejtën e ankimit në gjykatë ndaj lejes së ndërtimit, të miratuar në kundërshtim me ligjin dhe/ose dokumentet e planifikimit në fuqi.

2. Përgjegjësia, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, ushtrohet kur:

a) kërkohet nga vetë Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të njësisë vendore ose nga kryetari përkatës i saj, për shkak të pamundësisë financiare për ushtrimin e kësaj përgjegjësie nga inspektorati vendor;

b) inspektorati vendor nuk e ka inspektuar këtë territor më parë ose nuk është shprehur me vendim për ligjshmërinë ose jo të ndërtimit/punimit, në përputhje me afatet dhe procedurat ligjore;

c) vendimi i inspektoratit vendor për prishje të ndërtimit të kundërligjshëm nuk është ekzekutuar brenda afatit ligjor të caktuar në këtë ligj”.

Në përputhje me parashikimin ligjor, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të njësisë vendore, ose kryetari përkatës i tij, mund të kërkojë ndërhyrjen e IKMT-së, për të ushtruar kompetencat e këtij inspektorati vendor, për shkak të pamundësisë financiare për ushtrimin e kësaj përgjegjësie nga vetë inspektorati vendor.

Fakti është se gjatë hetimit administrativ të rastit nga ana juaj nuk rezulton të jetë cituar dhe aq më tepër të jetë sqaruar, pamundësia financiare për ekzekutimin e vendimit nr. 95, datë 26.06.2024 dhe nr. serie 0095 “Për prishjen e objektit të kundërligjshëm”. Po kështu, nuk ka asnjë sqarim të nevojshëm për pamundësinë e pretenduar njerëzore apo teknike, të organit tuaj publik, për ekzekutimin e vendimit të lartpërmendur.

Nga ana tjetër, fakti që ende nga ana juaj, nuk ka patur prej një kohe të gjatë asnjë reagim për zgjidhjen e kësaj çështjeje, me qëllim prishjen tërësisht të objektit të kundërligjshëm evidenton mosveprimin tuaj të vazhduar, në kundërshtim me kompetencat tuaja ligjore.

Pra, rezulton se ka mëse një vit që nuk mund të identifikohet asnjë justifikim i mundshëm ligjor për mosveprimin tuaj, të cilësuar në kushtet e keqadministrimit, për ekzekutimin e vendimit të sipërcituar për prishjen e objektit përkatës të kundërligjshëm.

Ky qëndrim në trajtimin e kësaj çështjeje identifikon qartazi keqadministrim në veprimtarinë tuaj të përditshme. Sjellim në vëmendjen tuaj se e drejta për mirëadministrim është afirmuar si një e drejtë themelore e qytetarisë në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian,³ sikundër parimet dhe standardet që lidhen me të drejtën për mirëadministrim. Këto parime dhe standarde kushtëzojnë veprimtarinë e organeve të administratës publike, duke u konceptuar si gurë themeli për garantimin e mirëadministrimit. Nga konstatimet e kryera dhe gjetjet e pasqyruara në këtë rekomandim vërehet se ka shkelje të elementëve proceduralë ligjorë, që garantojnë parimin e mirëadministrimit, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, si dhe ushtrimin efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga ana e organit tuaj publik.

Në këto rrethana, ndërhyrja dhe veprimi i nevojshëm nga ana e organit tuaj publik për ekzekutimin e këtij vendimi/dënimi administrativ, është një çështje urgjente, pasi vazhdimi i situatës mosvepruese shkakton dhe identifikon përgjegjësi ligjore.

Në trajtimin e kësaj çështjeje nga ana e IMT-së në Bashkinë Sarandë, del e qartë se ka një mosveprim të dukshëm të vazhduar dhe shmangie në marrjen e përgjegjësisë institucionale, si dhe të ushtrimit të kompetencave që ky organ publik gëzon në bazë të ligjit nr. 9780/2007.

³ Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian,³ u shpall në Samitin e Nises, në Dhjetor 2000.

Mosveprimi dhe zvarritja tërësisht e pajustificuar ligjërisht, e konstatuar në këtë çështje nxjerr në konkluzionin se kemi të bëjmë me cënim të së drejtës themelore të znj. S.I, për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar në paragrafin e parë të nenit 42, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenet 6 dhe 13, të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Për më tepër, kjo “ngecje” e zhvillimit të procedurës administrative që duhet përmbyllur me ekzekutimin e vendimit nr. 95, datë 26.06.2024 dhe nr. serie 0095 “Për prishjen e objektit të kundërligjshëm” evidenton shkelje të parimit të ligjshmërisë, parimit të procesit të rregullt ligjor, parimit të transparencës dhe informimit, parimit të dhënies së ndihmës aktive, si dhe të parimit të përgjegjësisë,⁴ parime shumë të rëndësishme këto që duhet të respektohen përgjatë gjithë veprimtarisë së organeve publike.

Është me vend të theksojmë se, mosveprimi i pajustificuar ligjërisht për ekzekutimin e vendimit nr. 95, datë 26.06.2024 dhe nr. serie 0095 “Për prishjen e objektit të kundërligjshëm”, mund të përbëjë shkak ligjor për kërkimin dhe nisjen e një procedure administrative për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor të shkaktuar ankuses, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 8510, datë 15.07.1999, “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës publike”, të ndryshuar.

Kjo pasi, mosveprimi nga ana e IMT-së në Bashkinë Sarandë, për trajtimin e këtij rasti në përputhje me kompetencat ligjore dhe lejimi i kësaj gjendjeje theksojmë se i ka shkaktuar dhe vijon t'i shkaktojë palës ankuese, një dëm të vazhduar.

Po ashtu, ushtrimi sipërfaqësor dhe jo konsequent i kompetencave të parashikuara nga ligji pamundëson realizimin e qëllimit, për të cilin ligji është miratuar nga ana e ligjvënësit. Kontrolli i pamjaftueshëm i territorit dëmton si të drejtat kushtetuese individuale, ashtu edhe të drejtat kushtetuese kolektive që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit.

Në këtë kuadër, duke e trajtuar si një pjesë integrale të këtij rekomandimi, tërheqim vëmendjen e kryetarit të Bashkisë Sarandë, si dhe të Këshillit Bashkiak Sarandë, për mungesën e kapaciteteve të nevojshme teknike që në rastin konkret kanë sjellë si pasojë mungesën e mbështetjes me mjete teknike të IMT-së në Bashkinë Sarandë, për ekzekutimin e vendimit nr. 95, datë 26.06.2024 dhe nr. serie 0095 “Për prishjen e objektit të kundërligjshëm”. Bashkërendimi dhe bashkëveprimi i organeve publike në funksion të kryerjes dhe përmbushjes së funksioneve publike është një kërkesë e vazhdueshme dhe e natyrshme e veprimtarisë së tyre.

Në këtë kuptim, organet publike përkatëse por sidomos Bashkia Sarandë, në trajtimin e kësaj çështjeje duhej të kishte konsideruar dhe parë mundësinë e kontraktimit të marrjes me qira të mjeteve të rënda të nevojshme nga subjekte private, në mbështetje të veprimtarisë së IMT-së

⁴ Këto parime parashikohen shprehimisht, përkatësisht, në nenet 4, 5, 6, 10, 15 dhe 16, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

në Bashkinë Sarandë për ekzekutimin e vendimit të sipërcituar, për prishje të objektit të kundërligjshëm. Kjo e konsideruar si një mundësi ligjore, për mbështetjen e nevojshme të veprimtarisë së IMT-së, në Bashkinë Sarandë. Institucionet shtetërore duhet të marrin masat për të realizuar me efektivitet dhe jo vetëm me dokumentacion shkresor detyrat e përgjegjësitë e tyre.

Nga informacioni zyrtar i dërguar për trajtimin e kësaj çështjeje nuk na rezulton që të jenë bërë përpjekje për gjetjen e një zgjidhjeje të tillë, që do të shmange këtë situatë të krijuar në shkelje të të drejtave të ligjshme të ankueses.

Zbatimi i ligjit dhe kompetencave që rrjedhin prej tij nuk duhet lejuar të bëhen çështje dëshire nga punonjësit, të cilëve iu ngarkohet kjo detyrë, pasi rigoziteti i kërkuar në këte drejtim bëhet gjithmonë shkak për kërkimin e përgjegjësive institucionale dhe individuale.

Ky mosveprim nuk jep imazhin e kërkuar të një organi publik në shërbim të qytetarëve, por të një organi publik që zvarrit zgjidhjen dhe bëhet shkak i shkeljes së të drejtave të ligjshme të individëve.

Avokati i Popullit nuk inkurajon ngritjen e asnjë ndërtimi të kundërligjshëm, prandaj ndan qëndrimin se kjo kulturë mosreaguese ndaj ndërtimeve pa leje duhet të mbarojë!

Nga ana tjetër, në përputhje me pikën 2, të nenit 15, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, organet e pushtetit publik në përmbushje të detyrave të tyre duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre dhe jo të bëhen shkak me mosveprimin e tyre, në vazhdimin e shkeljes dhe mosrespektimit të këtyre të drejtave.

Në vijim të analizës sonë, në kuadër të bashkëpunimit gjatë procesit të zhvillimit të hetimit administrativ, evidentojmë edhe një herë faktin se gjatë komunikimit institucional me Bashkinë Sarandë, IMT-në, ka rezultuar se edhe pse janë kthyer përgjigje në aspektin formal lidhur me kërkesat për shpjegime apo informacion të dërguara nga Avokati i Popullit, në vlerësimin tonë ato nuk mund të konsiderohen të tilla në aspektin substancial, pasi nuk i keni kthyer përgjigje në mënyrë të përsëritur, çështjeve të specifikuara për informacion nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit në funksion të përcaktimit të fakteve dhe rrethanave të cilat kanë rëndësi për zgjidhjen e drejtë të çështjes, si dhe nuk keni dërguar dokumentacionin e plotë ligjor lidhur me rastin. Duke e konsideruar refuzues qëndrimin e mbajtur prej Bashkisë Sarandë, IMT-së, në më shumë se në një rast, çojmë se ky qëndrim ka cënuar një ndër parimet më të rëndësishme, parimin e bashkëpunimit ndërmjet organeve të administratës publike.

Parimi i bashkëpunimit ndërmjet organeve të administratës publike, është sanksionuar si në parimet e Kodit të Procedurës Administrative, ashtu edhe në ligjin nr.90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e organeve të administratës shtetërore". Neni 3 i këtij ligji parashikon se: *"Administrata shtetërore organizohet dhe funksionon sipas parimeve të: unitetit dhe hierarkisë; llogaridhënies; dekoncentrimit; qartësisë në përcaktimin dhe shpërndarjen e përgjegjësisë; ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit, si dhe bashkëpunimit ndërmjet*

institucioneve të administratës shtetërore. Sipas parimit të bashkëpunimit, organet, institucionet dhe njësitë administrative, si dhe nëpunësit publikë, në të gjitha nivelet e administratës, bashkëpunojnë ndërmjet tyre, si dhe me organet e institucionet e pavarura, për arritjen e objektivave ligjorë që u janë besuar, në përputhje me ligjin”.

Në këtë kontekst, sqarojmë se bashkëpunimi gjatë hetimit administrativ është i lidhur ngushtësisht me parimin e transparencës dhe atë të llogaridhënies. Organet e administratës publike janë të detyruara të bashkëpunojnë për të mbështetur organin publik që kryen hetimin administrativ në funksion të përcaktimit të fakteve dhe rrethanave të çështjes. Transparenca dhe llogaridhënia janë dy nga parimet kryesore të mirëqeverisjes në administratën publike. Misioni i institucionit të Avokatit të Popullit në këtë drejtim është të kontribuojë në transparencën dhe llogaridhënien e organeve publike sa i përket ushtrimit të veprimtarisë administrative nga ana e tyre.

Mungesa e informacionit dhe e dokumentacionit, si dhe dërgimi i përgjigjeve të pjesshme, apo tej afatit të përcaktuar dhe atij të arsyeshëm ligjor, sjell zvarritjen e procesit administrativ dhe mohimin e të drejtës së qytetarëve për të gëzuar efektivisht të drejtat e tyre kushtetuese dhe për të përdorur mekanizmat kushtetues për garantimin e tyre. Kjo gjithashtu minon besimin e qytetarëve tek shteti i së drejtës dhe administrata shtetërore, ndërkohë që të gjitha përpjekjet në nivel europian por edhe të Këshillit të Evropës janë të drejtuara për nga ruajtja e besimit të publikut dhe përmirësimi i këtij indikatori.

Sa sipër, bazuar në neni 63, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga administrata publike”*, si dhe nenin 21, shkronja “b”, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, në të cilin parashikohet se : *“ Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit kryen këto veprime ... , b) paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”, c) Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”*;

REKOMANDOJMË:

- Ushtrimin nga ana e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, në Bashkinë Sarandë, të përgjegjësi, të përcaktuara në ligjin nr. 9780 datë 16.07.2007 *“Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”*, të ndryshuar, si dhe në legjislacionin specifik rregullator në fuqi, për ekzekutimin e vendimit nr. 95, datë 26.06.2024 dhe nr. serie 0095 *“Për prishjen e objektit të kundërligjshëm”*.
- Marrjen e masave për mospërsëritjen e kësaj praktike në të ardhmen, në procedurat administrative që do të ndiqen nga ana juaj për trajtimin e çështjeve të tjera, brenda

juridiksionit dhe kompetencave të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, në Bashkinë Sarandë.

- Marrjen e masave të nevojshme dhe të qëndrueshme financiare dhe administrative nga ana e Bashkisë Sarandë, për sigurimin e kapaciteteve të nevojshme teknike, që do të mbështesin dhe mundësojnë ushtrimin normal të veprimtarisë së Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, në Bashkinë Sarandë.
- Marrjen e masave përkatëse për të adresuar mungesën e komunikimit korrekt me institucionin e Avokatit të Popullit sa i përket kërkesave për informacion, në lidhje me të cilat përgjigjet kanë rezultuar me përmbajtje të paplota në disa aspekte, me qëllim që kjo situatë të mos përsëritet në të ardhmen.

Në zbatim të nenit 22, të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, brenda 30 ditësh nga marrja e këtij rekomandimi, lutemi të na vini në dijeni mbi qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi si dhe masat e marra për rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur.

Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj!

KOMISIONERE

ERINDA MELI

d.v